



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 10 korrik 2013, në orën 09:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z. Besim Beqaj, ministër i Financave; z. Kosum Aliu, NJQHAB-MF.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2012;**
3. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në rend dite të përfshihet procesverbali i datës 25 qershor 2013, 2 korrik 2013, (ora 9:00) dhe 2 korrik 2013 (ora 11:00).

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës me ndryshimet e propozuara nga kryetari.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 25 qershor 2013, 2 korrik 2013 (ora 09:00) dhe 2 korrik 2013 (ora 11:00)

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, mbajtur më 25 qershor 2013, 2 korrik 2013 ora 09:00 dhe 2 korrik 2013 ora 11:00.

2 Shqyrtimi i Raportit vjetor të Qeverisë për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, për vitin 2012

Kryetari - Bazuar në raportin e NJQHAB-së, vërehet se ka rritje të lehtë të numrit të auditimeve, ka rritje të numrit të njësive të auditimit të brendshëm, si dhe ka rritje të numrit të komiteteve të auditimit. Ky është tregues pozitiv për zbatimin e Ligjit për auditim të brendshëm. Përkundër të arriturave, megjithatë ende ka dobësi në fushën e auditimit të brendshëm, për shkak të mosngritjes së njësive të auditimit në disa organizata buxhetore në sektorin publik, si në Ministrinë e Diasporës, si dhe në 17 organizata buxhetore të nivelit qendror, për shkak të mospërmbushjes së kriterit për të pasur njësi të pavarur të auditimit, po paraqiten fusha të pambuluara. Mospagesa e anëtarëve të komiteteve të auditimit, si pengesë është Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe moskuptimi i drejtë i auditimit të brendshëm nga menaxhmenti, që përbën dobësi në fushën e auditimit të brendshëm. Mosadresimi i rekomandimeve të dala nga auditimet, si dhe mosadresimi i qartë i tyre, ende mbeten sfidë. Sipas raportit të NJQHAB-së, për vitin 2012 janë dhënë 2358 rekomandime. Të adresuara plotësisht janë 1247, të adresuara pjesërisht janë 654, si dhe të paadresuara 457. Edhe përkundër asaj se një pjesë e konsideruar e organizatave buxhetore kanë krijuar mekanizmat për auditim, prapëseprapë në një pjesë të organizatave buxhetore, veçanërisht në ato të nivelit komunal, nuk janë të funksionalizuara njësitë e auditimit, si dhe komitetet e auditimit si: në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Mamushë, Partesh, Klllokot, Hani i Elezit. Po ashtu, 17 organizata buxhetore të nivelit qendror, kanë bërë kërkesë që Ministria e Financave t'i mbulojë në fushat e auditimit, për arsye se nuk kanë auditorë, për shkak të kriterit mbi 50 të punësuar dhe mbi 1 milion euro buxhet. Nga 87 organizata buxhetore sa ishin për vitin 2012, 70 prej tyre i plotësojnë kriteret për të pasur njësi të brendshme të auditimit. Krahasuar me vitin 2011, në vitin 2012 kemi rritje prej 6 komiteteve të auditimit, 3 për nivelin qendror dhe 3 për nivelin komunal. Pra, nga 42 sa ishin për vitin 2011, në 48 për vitin 2012. Gjatë vitit 2011 janë kryer 392 apo 59 auditime, më pak se sa në vitin 2012, ku ishin kryer 451 auditime. Sfidë në vete mbetet plotësimi i pozitave të auditorëve në organizata buxhetore që kanë numër të vogël të të punësuarve, veçanërisht tek agjencitë e pavarura. Gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit, KMFP-ja ka vërejtur se në disa organizata buxhetore për shërbime të auditimit janë kontraktuar auditorë që punojnë në organizata buxhetore të tjera. Pse Ministria e Financave nuk po e kryen auditimin e këtyre institucioneve, nëse për këtë ka pasur kërkesë?

Ramiz Lladrovci- Përgëzoi ministrin për punën e mirë në këtë njësi. Kuvendi ka disa kërkesa për auditorë të brendshëm. Edhe ish- ministri i Financave ka premtuar se do të realizohen kërkesat për auditorë të brendshëm. P.sh. nevoja e auditimit në RTK.

Në një dëgjim të organizuar në Komunën e Mitrovicës, kryetari i Komunës ka ngritur shqetësimin që auditori i brendshëm nuk i ka komunikuar fare të gjeturat në komunë. A keni arritur që të trajtoni auditorët, që përveçse duhet t'ju raportojnë juve, të kenë një bashkëpunim me menaxherin kryesor, siç është kryetari? Pastaj mungesa e kryeshefit, ndoshta po krijon pengesa, sepse auditori do të raportonte të gjeturat te kryeshefi.

Murselj Haljilji - Numri i auditorëve të certifikuar është shumë i vogël. Për mendimin tim, ky është një problem i madh dhe më intereson të di se si do të zgjidhet kjo? Pastaj, në rekomandimet në fund të raportit, potencohet: “*duhet të krijohen njësitë e pavarura të auditimit*

të brendshëm në ato OB ku janë krijuar kushte”. A keni të dhëna se cilat janë këto organizata, a keni një listë të këtyre institucioneve që të jetë më lehtë për juve për të përmbushur këto rekomandime? Pastaj, edhe në rekomandimin tjetër flitet për “njësi të përbashkët të auditimit për agjencitë e pavarura, të cilat nuk i plotësojnë kriteret ligjore për auditorë të brendshëm”. A keni të dhëna se cilat janë këto OB të pavarura, të cilat nuk i plotësojnë kriteret ligjore për themelimin e këtyre njësive, por shfrytëzojnë kriterin që të kenë një auditor të përbashkët? Pra, a keni të dhëna se sa janë ato OB dhe si do të veprohet në të ardhmen lidhur me to?

Valbona Dibra – Komisioni po shqyrton raportin vjetor të punës. Është fakt i mirë që kjo njësi është duke u zhvilluar dita- ditës dhe po tregon progres të vazhdueshëm. Nëse e analizojmë me vëmendje raportin, shihet se NJQHAB-ja ka kryer një punë të mirë gjatë vitit 2012, pavarësisht disa sfidave të cilat u përmenden këtu. Kjo është një pasqyrë se në institucionet e vendit auditimi i brendshëm po kuptohet drejt dhe po përmirësohet në vazhdimësi. Nevoja për auditorë të brendshëm është paraqitur edhe në vitin e kaluar, mirëpo kjo çështje ka hasur në përkrahje të ish -ministri i Financave dhe të ministri aktual i Financave, për përkrahjen e sektorit të auditimit të brendshëm, duke pasur parasysh rolin auditorëve të brendshëm. Më gëzon fakti që gjatë vitit 2012, janë kryer një numër i madh i auditimeve dhe janë dhënë rekomandime që do të ndihmojnë punën e menaxhimit të parasë publike. Shqetësuese mbetet adresimi i rekomandimeve ku mbi 53% janë të adresuara, mbi 20% pjesërisht të adresuara, ndërsa 20% në proces të adresimit. Kjo pjesë e mosadresimit të rekomandimeve është me arsyetimin se janë dhënë në tremujorin e fundit dhe kjo lë për të shpresuar se do të adresohen në vitin në vazhdim.

Albert Kinolli – Përgëzoi ministrin për punën e bërë, përkundër faktit se u ngritën shumë shqetësime.

Imri Ahmeti – Duhet të jemi realë se gjendja nuk është aq e mirë sa prezantohet. Nëse i shohim raportet individuale të OB-ve dhe të NJQHAB-së, shohim se nuk janë në harmoni me njëra- tjetrën. Ka shumë rekomandime të paimplementuara. Duhet të kemi politika më insistuese të kësaj njësie, dhe në të njëjtën kohë, të shtojmë përgjegjësinë e auditorëve, krahas obligimeve që kanë. Auditorët janë të veçuar në paga dhe benefite të tjera, në raport me shërbyesit civilë dhe po të analizohet raporti i pagës me punën që bëjnë, duhet insistuar që roli i tyre të jetë më i fuqishëm, sepse duhet të kenë një rol më ndikues në OB. Sipas NJQHAB-së, synimi ishte që të ngritën njësitë e auditimit në tre auditorë. A ka standard për këtë, sepse OB-të kanë mjete buxhetore në shumë buxhetore të ndryshme dhe jo të gjitha OB-të janë në të njëjtën gjendje. Pastaj, ka raporte mospërfillëse nga menaxhmenti, por ka edhe raporte të auditorëve të brendshëm që injorojnë menaxhmentin. Ky raport në mes të menaxhmentit dhe auditorëve, duhet të rregullohet me norma ligjore.

Adem Grabovci – Raporti vlen të lëvdohet, por nuk duhet të ndiejmë kënaqësi, sepse jemi në fazën e konsolidimit të institucioneve dhe duhet të angazhohemi që kjo fushë të ngrihet ende më shumë. Duhet të auditohen dhe identifikohen më tepër dobësitë që na kanë përcjellë, sepse kur ne identifikojmë dobësitë-lëshimet gjatë punës, kjo është një mundësi për t'i korrigjuar ato. Ky sektor është shumë i rëndësishëm, që ndihmon t'i identifikojmë dobësitë tona, pastaj t'i përmirësojmë ato. Kërkojmë nga ministri që të na përkrahë në fuqizimin e këtij sektori siç është propozimi për auditimin e agjencive të pavarura.

Besim Beqaj, ministër i Financave- Jam i gatshëm që konform obligimeve ligjore të kontribuoj në menaxhimin e drejtë të parasë publike. NJQHA-ja, dita- datës po përmirësohet. Ka 5 vite që po raporton, por në këtë vit ka një përmirësim të dukshëm. Çështja e auditimit është çështje që vazhdon dhe gjithmonë ka hapësirë për përmirësim. Burimet e alokuara të shpenzohen në mënyrën më të plotë të mundshme. Kjo njësi ka mbështetjen e plotë të ministrit

të Financave, në mënyrë që të gjitha njësitë buxhetore të fuqizohen dhe jam i gatshëm të marrë përgjegjësinë që të përkrah edhe ato OB që nuk i kanë të themeluara këto njësi. Çështjen e mosadresimit të rekomandimeve, personalisht e kam ngritur te njësia, në mënyrë që kjo të mos mbetet në 50%, por të ngrihet shumë më shumë. Jam i kënaqur që kemi të bëjmë me një plotësim ligjor të kësaj fushe, pastaj trajnimi i vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi në mes të palëve të ndërlidhura. Ka rritje të njërive të auditimit të brendshëm, ka rritje të numrit të komiteteve të auditimit, janë trajnuar anëtarët e komiteteve të auditimit. Tani, së fundi, kemi marrë një hap shtesë, Njësia për kontroll të brendshëm, në kuadër të Thesarit, tani do të jetë në nivel të NJQHA-së, në mënyrë që të koordinohemi më mirë dhe të jenë të harmonizuara në mes vete. Kemi bashkëpunim të mirë me Komisionin Evropian, ku do të trajnohen rreth 100 zyrtarë dhe trajnim të kualifikimeve të trajnerëve vendorë në Institutin për Kontabilitet dhe Auditim në Britaninë e Madhe. Lidhur me çështjet e ngritura në Komision, ne do të merremi seriozisht me to dhe aty ku kemi hapësirë ligjore për përmirësim, do të ndërmarrim masa. Në njësitë buxhetore që duhet plotësuar me numër të auditorëve, do ta kenë përkrahjen time. Aspekti buxhetor, nuk do të jetë pengesë për auditorë të brendshëm. Sa i përket çështjes së agjencive të pavarura, ka nevojë që të themelohet njësia brenda Kuvendit, në mënyrë që të kenë një auditim nga Kuvendi, meqenëse këto agjenci, në një formë, janë përgjegjëse drejtpërdrejt para Kuvendit.

Auditorët janë këshillues të menaxhmentit dhe normalisht raportet duhet të jenë në një nivel të tillë. Nuk duhet të jetë njëri raport dominues në raport me tjetrin. Lidhur me këtë çështje, duhet të shohim se cili mund të jetë bashkëpunimi i tyre me NJQHAB-në, që të harmonizohen dhe këto raporte, me qëllim të përmirësimit të shpenzimit të parasë publike. Menaxhmenti duhet t'i trajtojë me seriozitet raportet e auditorëve të brendshëm dhe harmonizimi i raportit në mes të auditorit dhe menaxherit është çështje me të cilën duhet të merremi të gjithë.

Kosum Aliu, NJQHAB, drejtor - Çështja e auditimit të brendshëm, tashmë është kuptuar drejt. Ka shumë çështje për të cilat po punojmë për avancimin e tyre. Fokusi kryesor është që të fuqizohet kontrolli i brendshëm. Me vendimin e ri, NJQHAB-ja duhet të ngrihet në nivel të ministrit për një nivel më të fuqishëm të veprimtari në terren. Në bashkëpunim me KE, jemi duke përgatitur një strategji për këtë çështje. Tani kemi trajnerët tanë, të cilët në këtë vit nën monitorim po bëjnë trajnimin 70 auditorëve. Ne kemi kërkuar nga projekti që të bëjnë trajnimin e 16 trajnerëve për kontrole të brendshme. Ata do ta luajnë rolin e trajnerëve vendorë nëpër OB. Aktualisht, janë 100 zyrtarë duke u trajnuar nëpër këto module. Kemi paraparë tri pilot- projekte, në mënyrë që të krijojmë një model të funksionimit të kontroleve të brendshme. Njësitë e auditimit të brendshëm dhe mungesa e stafit. Një njësi e auditimit të brendshëm duhet të ketë së paku 3 auditorë, për hir të objektivitetit. Këto njësi duhet të jenë profesionale prej tre auditorëve të brendshëm. Në nivelin e Qeverisë është kompletuar çështja e njësive të auditimit. Problem ende në fokus të NJQHAB-së, janë komunat. Po ashtu, edhe Kuvendi duhet të themelojë një njësi për auditim të agjencive, të cilat i përgjigjen Kuvendit. Fokus tjetër është trajnimi i stafit për auditim të performancës. Presim donacione prej vendeve të ndryshme, dhe një prej kriterëve për të marrë donacion, do të jetë që së paku tre vitet e fundit, institucioni të ketë opinion të pakualifikuar. Komitetet e auditimit janë funksionale dhe është duke u nxjerrë një UA për pagesën e këtyre anëtarëve të komiteteve të auditimit.

Imri Ahmeti - Propozoi që në rekomandimin e Komisionit duhet të përfshihet dhe një rekomandim, që MF të nxjerrë rregullativë ligjore, për të rregulluar raportet në mes të menaxhmentit të OB-ve, auditorëve të brendshëm dhe të NJQHAB-së.

Ramiz Lladrovci- Tha se ka rregullativë ligjore për këtë çështje, por problemi ka qenë se ata e kanë konsideruar vetën të pavarur nga menaxhmenti dhe kjo ka krijuar probleme.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

- 1. Të miratohet Raporti i Qeverisë për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2012.**
- 2. Ministria e Financave, të përkrahë kërkesat e institucioneve buxhetore, lidhur me rritjen e numrit të stafit për pozita të auditorëve të brendshëm.**
- 3. Në kuadër të Kuvendit të Kosovës, të themelohet Njësia prej tre zyrtarësh, për auditimin e institucioneve të pavarura, të themeluara nga Kuvendi, e që sipas Ligjit mbi auditimin e brendshëm, nuk i plotësojnë kushtet për të pasur auditorë të brendshëm.**
- 4. Arsyetimin e Rekomandimit do ta paraqesë, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu